



Pyetjet më të shpeshta për licencimin e siguruesve

Përmbajtja

Pyetjet më të shpeshta për licencimin e siguruesve	5
Të përgjithshme.....	5
1. Kush është BQK?	5
2. Çfarë janë institucionet financiare?.....	5
3. Çfarë do të thotë sigurues?.....	5
4. Çfarë do të thotë subjekti i varur?.....	5
5. Çfarë do të thotë sigurues i jashtëm?.....	6
6. Çka do të thotë risigurues?.....	6
7. Kur mund ta quaj veten sigurues?.....	6
8. A mund të ketë siguruesi/risiguruesi statut tjetër përveç shoqërisë aksionare?	6
9. Çfarë është licenca?.....	6
10. Çfarë veprimtari financiare janë të lejuara për siguruesit në Kosovë?.....	6
11. Ku duhet të aplikojë për t'u pajisur me licencë për sigurues?	7
12. A ka rëndësi nëse unë nuk jam me qendër në Kosovë?	7
13. Sa sigurues janë të licencuara në Kosovë?.....	7
14. Kush duhet të jetë prezentë në takimin informues nga ana e aplikuesit?.....	7
15. Në takimin informues a mund të merre pjesë vetëm përfaqësuesit e aksionarëve?.....	7
16. Cilët janë aksionarët kryesor të siguruesit?	7
17. Çfarë duhet të përgatiti për takimin informues?	7
18. Kur mund të fillojë të përgatisë aplikacionin për licencim si sigurues?.....	8
19. Çfarë dokumentesh duhet të dorëzojë si aplikacion për licencim si sigurues?	8
20. Sa shpejt mund të bëhem sigurues?.....	8
Para aplikimit.....	8
21. A duhet të kaloj nëpër procesin e para-aplikimit?.....	8
22. Çka është plani i biznesit?.....	8
23. A janë ndërveprimet e mia me ju konfidenciale?	9
24. Sa është kapitali minimal i kërkuar për hapjen e një siguruesi të ri?.....	9
25. A aplikohet kërkesa për kapital edhe me rastin e hapjes së një dege të siguruesit të jashtëm (huaj) në Kosovë?.....	9
26. Kush mund të jetë aksionar i siguruesit?	9
27. Çfarë prejardhje mund të kenë fondet për investim në formë të kapitalit?.....	9

28.	<i>A mund të lëshojmë aksione në këmbim të shërbimeve?</i>	10
29.	<i>Sa anëtar mund të ketë bordi i drejtorëve të një siguruesi?</i>	10
30.	<i>A munden aksionarët të jenë anëtarë të bordit të drejtorëve?</i>	10
31.	<i>Cka kuptohet me drejtorë joekzekutiv?</i>	10
32.	<i>A mundet kryeshefi ekzekutiv të jetë anëtar i bordit të drejtorëve?</i>	10
33.	<i>Çfarë do të thotë i përshtatshëm dhe i dubur për drejtorët dhe menaxherët e lartë?</i>	10
34.	<i>Kur, ku dhe si dubet ta dorëzojë aplikacionin për licencë siguruesi?</i>	11
35.	<i>Ku mund të lexoj më shumë për qasjen e BQK-së për licencimin e siguruesve të jashtëm?</i>	11
36.	<i>A kam nevojë të punësoj këshilltarë ose konsulentë të jashtëm?</i>	11
37.	<i>A mund të rekomandoni ndonjë këshilltar ose konsulent të jashtëm?</i>	11
38.	<i>A mund t'i sjell këshilltarët e mi në takimet me ju?</i>	11
39.	<i>A mund të përdor ofruesit e shërbimeve të kontraktuara?</i>	11
40.	<i>A specifikoni cilat sisteme të TI dubet të përdorni?</i>	11
41.	<i>A mund të rekomandoni ndonjë sistem / ofrues të TI-së?</i>	11
42.	<i>Çfarë dubet të bëjë nëse në ndërkohë gjatë aplikimit gjërat ndryshojnë?</i>	11
43.	<i>Sa është tarifa e licencimit të siguruesve?</i>	12
44.	<i>Ku mund të gjej detajet e tarifave të aplikimit?</i>	12
45.	<i>Pse dubet të paguaj një tarifë?</i>	12
Pas aplikimit		12
46.	<i>Çfarë ndodhë pas aplikimit në BQK për licencë të siguruesit?</i>	12
47.	<i>Sa zgjatë vlerësimi i aplikacionit për licencim të siguruesve?</i>	12
Miratimi paraprak		13
48.	<i>Cilat kushte dubet të plotësojë në mënyrë që aplikacioni im për licencë të miratohet në BQK?</i>	13
49.	<i>A dubet të plotësoj të gjitha kriteret e licencimit?</i>	13
50.	<i>A ka ndonjë kusht tjetër që merret parasysh nga BQK si kriter për licencim në BQK?</i>	14
51.	<i>Çfarë do të thotë miratim paraprak i licencës?</i>	14
52.	<i>Për çfarë periudhe kohore dubet të plotësoj kushtet për miratim të licencës përfundimtare?</i>	14
Licencimi		14
53.	<i>Çfarë ndodhë nëse ndonjëra nga informatat e dorëzuara me aplikacion ndryshon gjatë periudhës së vlerësimit të aplikacionit tim në BQK?</i>	14
54.	<i>Çfarë dubet të bëjë pas plotësimit të kriterëve për licencë përfundimtare?</i>	15
55.	<i>Çfarë do të thotë Ekzaminimi parabhapjes?</i>	15

56.	<i>Sa zgjatë vlerësimi i aplikacionit për licencë përfundimtare?.....</i>	15
57.	<i>A mund të refuzohet aplikimi im?.....</i>	15
58.	<i>A mund të apeloj nëse refuzohet kërkesa ime?.....</i>	15
59.	<i>A mund të filloj aktivitetet e organizmit para se të licencohem?.....</i>	16
60.	<i>Nëse firma ime tashmë është e autorizuar, a mund të vazhdojmë me atë që ne tashmë e bëjmë?.....</i>	16
Siguruesit e jashtëm (huaj).....		16
61.	<i>Cili është dallimi në mes të një filiali dhe një dege?</i>	16

Pyetjet më të shpeshta për licencimin e siguruesve

Pyetjet më të shpeshta që BQK pranon nga të interesuarit për aplikim për licencim të siguruesve janë organizuar në kategoritë e mëposhtme:

- Të përgjithshme;
- Para aplikimit;
- Pas aplikimit;
- Miratimi paraprak;
- Licencimi;
- Siguruesit e jashtëm (huaj).

Të përgjithshme

1. Kush është BQK?

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është një institucion publik i pavarur, objektivi parësor i së cilës është nxitja dhe ruajtja e një sistemi të qëndrueshëm financiar si dhe një sistemi efikas të pagesave. Është autoriteti i vetëm për licencim, rregullim dhe mbikëqyrje të institucioneve financiare në Kosovë. Përgjegjësitë dhe objektivat e BQK-së janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (linku <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2010/Ligji%20per%20BQK-ne.pdf>, më tutje ligji për BQK) si dhe Ligjin Nr. 05/L-045 për Sigurimet (linku http://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Ligji%20Nr.%2005%20L-045%20per%20Sigurimet.pdf më tutje ligji për sigurimet).

2. Çfarë janë institucionet financiare?

Institucione Financiare nënkupton subjektet si: banka, kompani të sigurimeve, fonde pensionale, institucione mikrofinanciare, institucione financiare jobankare, ndërmjetësues në sigurime, trajtues të dëmeve si dhe subjekte tjera juridike që ushtrojnë aktivitete financiare siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe sipas të cilit Bankës Qendrore i është dhënë autoritet për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e tyre.

3. Çfarë do të thotë sigurues?

Sigurues nënkupton personin juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari të sigurimeve sipas përcaktimeve të Ligjit për Sigurime, duke përfshirë këtu edhe subjektet e varura ose degët e siguruesve të jashtëm (huaj).

4. Çfarë do të thotë subjekt i varur?

Subjekt i varur nënkupton personin juridik të veçantë i themeluar nga siguruesi ose personi juridik, që është nën kontroll të përbashkët me siguruesin.

5. *Çfarë do të thotë sigurues i jashtëm?*

Sigurues i jashtëm nënkupton degën e siguruesit të jashtëm, e cila ka selinë kryesore në ndonjë vend të jashtëm dhe është licencuar për të ushtruar aktivitetet sigurues në Republikën e Kosovës.

6. *Çka do të thotë risigurues?*

Risigurues nënkupton personin juridik, i licencuar për të ushtruar veprimtari risigurimi sipas përcaktimeve të ligjit për sigurime.

7. *Kur mund ta quaj veten sigurues?*

Asnjë person nuk mund të përdorë fjalën “sigurim”, “risigurim”, “ndërmjetësues në sigurime” “trajtues i dëmeve” ose derivatet e këtyre fjalëve në lidhje me një veprimtari, produkt ose shërbim ose në veprimtari promocionale pa pasur një licencë të lëshuar nga BQK-ja, për t'u përfshirë në aktivitetin e sigurimeve, përveç kur një përdorim i tillë është vendosur ose njohur me këtë ligj. Asnjë zyre përfaqësuese nuk mund të përdorë fjalën “sigurim” në emrat e tyre, përveç rasteve kur fjala “sigurim” formon një pjesë integrale të emrit të siguruesit të jashtëm të cilit ato i përkasin me kusht që, në raste të tilla të shtohet fjala “zyra përfaqësuese”.

Ju mund të filloni procesin e aplikimit si 'Shembull' sha, dhe vetëm kur të jeni të licencuar mund ta riemërtoni veten 'Shembull sigurim' sha.

Emrat e domain-it (web faqes) dhe adresat e emailit kontrollohen në mënyrë të ngjashme dhe ju duhet të keni kujdes në përdorimin e fjalëve të ndjeshme duke përfshirë fjalën “sigurim”, “risigurim”, “ndërmjetësues në sigurime”, “trajtues i dëmeve” ose derivatet e këtyre fjalëve.

8. *A mund të ketë siguruesi/risiguruesi statut tjetër përveç shoqërisë aksionare?*

Jo. Çdo sigurues/risigurues që aplikon për licencim në BQK duhet të jetë e regjistruar si Shoqëri Aksionare. Në rastet kur aplikohet si degë e siguruesit të jashtëm, siguruesi amë duhet të jetë e regjistruar si Shoqëri Aksionare.

9. *Çfarë është licenca?*

Licencë është autorizim i lëshuar nga BQK-ja për dhënien e të drejtës për tu marrë me veprimtaritë e specifikuar sipas atij autorizimi.

10. *Çfarë veprimtari financiare janë të lejuara për siguruesit në Kosovë?*

Siguruesit në Kosovë, mund të licencohen për te ofruar sigurime jo jetë ose sigurime jetë.

Siguruesi i licencuar për angazhim në çdo lloj të sigurimit të jo-jetës, nuk duhet të ofrojë sigurimin e jetës dhe anasjelltas.

Licenca për veprimtarinë e sigurimit të jo-jetës, jepet për klasa të veçanta, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Sigurimet.

Licenca për veprimtarinë e sigurimit të jetës jepet veçmas ose për të gjitha klasat në pajtim me dispozitat e Ligjit për Sigurimet.

11. Ku duhet të aplikojë për t'u pajisur me licencë për sigurues?

Për tu pajisur me licencë për sigurues në Republikën e Kosovës, ju duhet të kontaktoni Departamentin e Licencimit dhe Standardizimit, përmes emailit (Licencimi@bqk-kos.org) apo telefonit (+381 38 222 055), ku do të merreni udhëzimet e nevojshme për aplikim. Aty do të informoheni edhe se para se të filloni me procesin e aplikimit është e obliguar mbajtja e takimit informues me përfaqësuesit e BQK.

12. A ka rëndësi nëse unë nuk jam me qendër në Kosovë?

BQK i mirëpret kërkesat nga çdo sigurues të ri me një model biznesi të shëndoshë pavarësisht se ku kanë institucionin “mëmë” të themeluar. Nëse ju jeni një sigurues me seli në cilindo vend të botes, ju mund të veproni në Kosovë si një filiale ose degë (ose të dyja) - ju lutemi shikoni të dhënat e IV - Siguruesit e Jashtëm të Manualit të Licencimit të Siguruesve për më shumë detaje.

13. Sa sigurues janë të licencuara në Kosovë?

Siguruesit e licencuar në Republikën e Kosovë mund t'i gjeni në web faqen e BQK-së.

14. Kush duhet të jetë prezentë në takimin informues nga ana e aplikuesit?

Në takim duhet që të marrin pjesë të gjithë aksionarët kryesor të siguruesit të ri të propozuar.

15. Në takimin informues a mund të merre pjesë vetëm përfaqësuesit e aksionarëve?

Jo, në takim duhet të jenë prezent të gjithë aksionarët kryesor të siguruesit të ri të propozuar.

16. Cilët janë aksionarët kryesor të siguruesit?

Aksionar kryesor çdo person (juridik dhe fizik) që posedon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, së bashku ose në bashkëveprim me persona tjerë, dhjetë (10) përqind ose më tepër të çfarëdo klase të aksioneve me të drejtë vote të një siguruesi ose shoqërie apo dhjetë (10) përqind të interesit në kapital në një sigurues ose shoqëri.

17. Çfarë duhet të përgatiti për takimin informues?

Para mbajtjes së takimit informues të interesuarit për aplikim duhet të përgatiten për të prezantuar në takim një përmbledhje të shkurtër të nivelit të lartë të propozimit të biznesit, që si minimum duhet të përmbajë:

- arsyeshmërinë e themelimit të siguruesit si dhe strategjinë fillestare të biznesit duke specifikuar se cilat produkte do të ofrohen, si do t'i ofrohen ato dhe tregun e synuar;
- burimet e financimit - si do të financohen dhe nëse kanë ndonjë investitor dhe/ose fonde në vend;
- pronësinë dhe ekipin menaxherial - detajet e pronarëve dhe menaxherëve të propozuar, për aq sa ato njihen;
- planin kohor- një pasqyrë dhe afat kohor të planit për të themeluar siguruesin e ri.

18. Kur mund të fillojë të përgatisë aplikacionin për licencim si sigurues?

Pas mbajtjes së takimit informues dhe dërgimit të formave për aplikim nga BQK, ju mund të fillojnë përgatitjen e aplikacionit për licencim si sigurues në BQK.

19. Çfarë dokumentesh duhet të dorëzojë si aplikacion për licencim si sigurues?

Aplikacioni për licencim si sigurues duhet të shoqërohet nga informacionet e kërkuara në nenin 10 të Ligjit për Sigurime. Kjo pjesë fillon me listimin e dokumenteve mbështetëse që duhet të jenë pjesë e aplikacionit për licencim si sigurues.

20. Sa shpejt mund të bëhem sigurues?

Nuk ka përgjigje të thjeshtë për këtë pyetje. Faza e para-aplikimit nuk ka një afat kohor të përcaktuar dhe shpejtësia e përparimit varet kryesisht nga pala e interesuar për licencim. BQK është e interesuar për cilësinë e materialit që ju përgatitni më tepër sesa sasinë ose shpejtësinë në të cilën ju përgatiteni. Megjithatë, çdo reagim që japim duhet të konsiderohet me kujdes nga ana e palës së interesuar për licencim. Pasi të keni paraqitur kërkesën tuaj, do të aplikojë një afat ligjor prej nëntëdhjetë (90) ditësh për të arritur një vendim për aplikimin tuaj - ju lutemi shihni fazën e Aplikimit në Manualin për Licencimin e Siguruesve për më shumë detaje.

Para aplikimit

21. A duhet të kaloj nëpër procesin e para-aplikimit?

Po. Ju duhet që të ndiqni procesin e para-aplikimit, kjo është kërkesë formale e BQK-së. Keni parasysh që palët e interesuara për licencim që janë më proaktive në fazën e para-aplikimit, paraqesin një kërkesë shumë më cilësore që BQK mund ta vlerësoj më lehtë.

22. Çka është plani i biznesit?

Plani i biznesi është një përshkrim i biznesit tuaj të propozuar, që përmban detajet e objektivave tuaja dhe si do t'i arrini ato. Plani juaj i biznesit duhet të përshtatet me aktivitetet që firma juaj ka në plan të ndërmarrë duke marrë parasysh edhe kriteret e licencimit të BQK-së. Plani i biznesit, për të qenë i pranueshëm nga BQK, duhet minimalisht të përmbajë informatat e mëposhtme:

- pasqyrën e biznesit: strategjinë e përgjithshme të siguruesit të propozuar dhe detajet mbi veprimtarinë e planifikuar siguruese;
- analizën e tregut duke përfshirë analizën e konkurrencës direkte dhe indirekte;
- analizën financiare ku përfshihet shpalosja e strukturës së asetëve, detyrimeve dhe kapitalit si dhe projeksionet financiare për tre (3) vitet e para të operimit, si dhe programin e planifikuar për ri-sigurimin;
- funksionet e rëndësishme siguruese;
- strukturën udhëheqëse të siguruesit.

Nëse paraqitni një plan biznesi të paplotë ose të paqartë, kjo do të shkaktojë vonesa në vlerësimin e aplikacionit tuaj, pasi BQK do të duhet të bëjë pyetje të mëtejshme ose të kërkojë informacione të mëtejshme për të fituar një pasqyrë të qartë të biznesit tuaj. Megjithatë, plani juaj i biznesit edhe mund të evoluojë gjatë procesit të para-aplikimit, përderisa zhvilloni modelin tuaj të biznesit dhe merrni komentet nga BQK. Plani i Biznesit është një pjesë e rëndësishme e aplikimit tuaj të përgjithshëm dhe është pjesë përbërëse e vendimmarrjes së BQK-së. BQK do ta përdor atë për të vlerësuar rreziqet që biznesi juaj i paraqet për objektivat tuaja dhe se si planifikoni t'i kontrolloni dhe menaxhoni ato. Ju gjithashtu duhet të përdorni planin tuaj të biznesit për t'ju ndihmuar të fokusoheni në drejtimin e aktiviteteve tuaja dhe organizimin e burimeve për të arritur objektivin tuaj.

23. A janë ndërveprimet e mia me ju konfidenciale?

Po. Të gjitha pyetjet dhe informatat që BQK pranon do të trajtohen si konfidenciale.

24. Sa është kapitali minimal i kërkuar për hapjen e një siguruesi të ri?

Aplikuesi për licence si sigurues për të ushtruar veprimtra i të sigurimet jo jetë duhet të ketë kapital themeltar në vlere prej jo më të ulët se dy milion e dyqind mijë (2,200,000) euro. Në rastin kur një ose disa rreziqe përfshihen në klasat 10 deri në 15 të nenit 7 të Ligjit për Sigurimet, atëherë kapitali themeltar nuk mund të jetë më i ulët se tre milion e dyqind mijë (3,200,000) euro.

Aplikuesi për licencë si sigurues për të ushtruar veprimtari të sigurimeve jetë, duhet të ketë kapital themeltar në vlere jo më të ulët se tre milion e dyqind mijë (3,200,000) euro.

Përveç kapitalit themeltar të përmendur më lartë, siguruesi duhet të ketë edhe një fond shtesë për shpenzime fillestare, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se njëzet përqind (20%) vlerës së kapitalit themeltar.

25. A aplikohet kërkesa për kapital edhe me rastin e hapjes së një degë të siguruesit të jashtëm (huaj) në Kosovë?

Po. Të njëjtat kërkesa për kapital vlejné edhe për degë të siguruesve të jashtëm (huaj).

26. Kush mund të jetë aksionar i siguruesit?

Aksionar i siguruesit mund të jetë çdo person i cili është i përshtatshëm dhe vërteton qëndrueshmërinë financiare.

27. Çfarë prejardhje mund të kenë fondet për investim në formë të kapitalit?

Kapitali minimal duhet të paguhet në para të gatshme dhe fondet e tij nuk mund të rrjedh nga aktivitetet jologjore. Kontributet për kapitalin e siguruesit nuk duhet të burojnë nga fondet e marra hua nga publiku, kredi bankare si dhe fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme.

Për të vërtetuar burimin e parave për kapitalin themeltar dhe shtesën e këtij kapitali në BQK, dorëzohet dokumentacioni i mëposhtëm:

- për personat juridikë:

- evidencë për burimin e krijimit të kapitalit, si raporti i auditorit të jashtëm të pavarur, pasqyrat financiare vjetore, dhurata apo burime të tjera të destinuara për t'u përdorur në blerjen e aksioneve të siguruesit;
 - vërtetim i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili jep të dhëna për bilancin e personit juridik dhe për përmbushjen e detyrimeve tatimore.
- për personat fizikë:
- evidencë për burimin e krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka apo vërtetime të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;
 - vërtetime që dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore.

Nëse prejardhja e kapitalit themeltar nuk është e qartë për BQK-në, kjo përbën bazë për refuzim të licencës.

28. A mund të lëshojmë aksione në këmbim të shërbimeve?

Aksionet e lëshuara në këmbim të shërbimeve nuk trajtohen si kapital i paguar. Gjithashtu edhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose për qiramarrjen e lokaleve të punës dhe pajisjeve, si dhe shpenzimet e tjera operative nuk përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal.

29. Sa anëtar mund të ketë bordi i drejtorëve të një siguruesi?

Bordi i drejtorëve përbëhet nga numri tek prej jo më pak se pesë (5) anëtarë, me të drejtë vote. Të gjithë anëtarët e bordit të drejtorëve me të drejtë vote, duhet të jenë drejtor joekzekutiv.

30. A munden aksionarët të jenë anëtarë të bordit të drejtorëve?

Po munden, vetëm duhet të keni parasysh që anëtarët e bordit të drejtorëve duhet të kenë pavarësi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre në mënyrë që të mos cenohen interesat e siguruesit nga konflikti i interesit që mund të krijohet gjatë ushtrimit të detyrës.

31. Cka kuptohet me drejtorë joekzekutiv?

Drejtor joekzekutiv nënkupton anëtarët e bordit të drejtorëve, të cilët nuk janë menaxher të lartë apo punonjës të siguruesit dhe nuk janë të përfshirë në menaxhimin operacional të tyre.

32. A mundet kryeshefi ekzekutiv të jetë anëtar i bordit të drejtorëve?

Po. Kryeshefi Ekzekutiv është anëtar i bordit të drejtorëve sipas detyrës zyrtare, por nuk ka të drejtë vote.

33. Çfarë do të thotë i përshtatshëm dhe i duhur për drejtorët dhe menaxherët e lartë?

Përshtatshmëria e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të propozuar konsiderohet si thelbësore në procesin e BQK-së për licencimin dhe mbikëqyrjen e siguruesve. Si pjesë e procesit të licencimit, nenet 24, 27 dhe 32 të Ligjit për Sigurimet, Rregullorja për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm kanë përcaktuar kriterin “i përshtatshëm dhe i duhur” dhe kriterin e pavarësisë për miratimin e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë. Elementet të cilat merren në konsideratë për këto kritere përfshijnë: të dhënat mbi veprat penale, pozitën financiare, veprimet civile kundër individëve për ndjekjen e borxhit personal, refuzimi i anëtarësimit apo përjashtimi nga organizatat profesionale, sanksione të zbatuara nga rregullatorët e industrive të ngjashme dhe praktikatat e mëhershme të dyshimta të biznesit. Çdo aksionar kryesor, drejtor,

menaxher i lartë si dhe aktuari i siguruesit duhet të përmbushin kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur, në lidhje me pozicionin përkatës

34. Kur, ku dhe si duhet ta dorëzohet aplikacionin për licencë siguruesi?

Aplikacionin duhet ta dorëzoni, pasi që të keni plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, në BQK në formë fizike dhe elektronike.

35. Ku mund të lexoj më shumë për qasjen e BQK-së për licencimin e siguruesve të jashtëm?

Për procesin e licencimit të siguruesve ju mund të lexoni në Ligjin NR. 05/L -045 për sigurimet (linku http://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Ligji%20Nr.%2005%20L-045%20per%20Sigurimet.pdf); rregulloren për licencimin e siguruesve dhe degëve të siguruesve të jashtëm (linku:http://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Finale%20Rregullore%20per%20Licencimin%20e%20Siguruesve%20dhe%20degeve.pdf).

36. A kam nevojë të punësoj këshilltarë ose konsulentë të jashtëm?

Kjo varet vetëm nga ju, por BQK nuk kërkon nga ju që ta bëni këtë. Shumë aplikues e vlerësojnë të dobishme angazhimin e këshilltarëve të jashtëm ose konsulentë, ndërsa të tjerët vlerësojnë se kanë nivelin e duhur të ekspertizës brenda stafit të tyre.

37. A mund të rekomandoni ndonjë këshilltar ose konsulent të jashtëm?

Jo, BQK nuk mund të rekomandoj ndonjë këshilltarë të veçantë të jashtëm ose konsulentë.

38. A mund t'i sjell këshilltarët e mi në takimet me ju?

Po ju mund t'i sjellni, por BQK nuk pret që ata të flasin në emrin tuaj.

39. A mund të përdor ofruesit e shërbimeve të kontraktuara?

Po, me disa përjashtime. Por një gjë duhet të keni parasysh që ju si biznes mbani përgjegjësin e plotë për të përmbushur përgjegjësitë tuaja ligjore pa marrë parasysh nëse është funksion i deleguar apo jo.

40. A specifikoni cilat sisteme të TI duhet të përdorni?

BQK nuk specifikon cilat sisteme të TI duhet të përdorni. Aktivitetet e rregulluara të firmës suaj duhet të mbështeten nga shërbimet e TI-së të cilat janë efektive, fleksibile dhe të sigurta si dhe janë të dizajnuara në mënyrë të përshtatshme për të plotësuar nevojat e ardhshme të pritshme, si dhe nevojat aktuale të biznesit.

41. A mund të rekomandoni ndonjë sistem/ofrues të TI-së?

Jo, BQK nuk mund të rekomandoj ndonjë sistem/ofrues të TI-së.

42. Çfarë duhet të bëj nëse në ndërkohë gjatë aplikimit gjërat ndryshojnë?

Nëse ka ndonjë ndryshim në lidhje me planet tuaja duhet të kontaktoni BQK-në më së largu pesë (5) ditë nga data e ndryshimit dhe të diskutoni për këto ndryshime.

43. Sa është tarifa e licencimit të siguruesve?

Tarifa e licencimit të siguruesve është dhjetë mijë (10,000.00) Euro.

44. Ku mund të gjej detajet e tarifave të aplikimit?

Të gjitha tarifat e kërkuara të aplikimit janë të paraqitura në Skemën e Tarifave që gjendet në ueb-faqen zyrtare të BQK-së (<http://bqk-kos.org/?id=88>) dhe janë të pakompensueshme, pa marrë parasysh vendimin e BQK-së. Aplikacionet konsiderohen të pa kompletuara, dhe rrjedhimisht nuk shqyrtohen, nëse tarifa e licencimit nuk është paguar.

45. Pse duhet të paguaj një tarifë?

BQK financohet nga tarifat dhe taksat që duhet të paguhen nga subjektet që i licencen, rregullon dhe mbikëqyr. Si pjesë e kësaj BQK kërkon një tarifë për shqyrtimin e një aplikimi për të licencuar një sigurues të tij.

Pas aplikimit

46. Çfarë ndodhë pas aplikimit në BQK për licencë të siguruesit?

Pas dorëzimit formal të aplikacionit për licencim të siguruesit, BQK bën vlerësimin e parë ku verifikohet nëse aplikacioni i dorëzuar është i plotë ose jo. Që aplikacioni të vlerësohet i plotë, duhet të dorëzohen në BQK të gjitha format e kërkuara, të cilat duhet të jenë plotësuar plotësisht dhe në mënyrë korrekte dhe informacioni i ofruar duhet të jetë i cilësisë dhe detajeve të mjaftueshme për të lejuar BQK-së përfundimin e vlerësimin. Gjithashtu që të vlerësohet i plotë aplikacioni, duhet t'i ketë të inkuorporuara përgjigjet ndaj komenteve të BQK-së të ofruara gjatë fazës së para-aplikimit.

47. Sa zgjatë vlerësimi i aplikacionit për licencim të siguruesve?

BQK-ja brenda 90 ditësh pas ditës së pranimit të aplikacionit, e shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe e njofton aplikuesin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është kompletuar. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i kompletuar dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara me rregullativen në fuqi, BQK-ja do të njoftojë aplikuesin për mangësitë, dhe do të kërkoj nga aplikuesi informata ose dokumente shtesë të nevojshme. Afati për paraqitjen e informatave ose dokumenteve shtesë është jo me vonë se 90 ditë pas njoftimit. Nëse informatat ose dokumentet shtesë të kërkuara janë paraqitur brenda afatit, BQK do ta njoftoj palën se aplikacioni është i kompletuar. BQK-ja ndërpret procedurat e shqyrtimit të aplikacionit për licencim në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni shtesë i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga aplikuesi brenda 90 ditësh pas datës së njoftimit për informata dhe dokumentacion shtesë. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të aplikacionit për licencim, BQK-ja e njofton me shkrim aplikuesin.

BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon dhënien e licencës paraprake si sigurues ose si degë e siguruesit të jashtëm brenda tre (3) muajve nga data e njoftimit të aplikantit se aplikacioni për licencim është i kompletuar. Për vendimin e marrë BQK-ja menjëherë e informon aplikuesin. Gjatë periudhës së shqyrtimit të aplikacionit BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë apo ndryshime/përmirësime të caktuara

kur vlerësohen të arsyeshme. Kërkesa për informata shtesë sqaruese në këtë fazë nuk do të ndikojë në zgjatjen e periudhës prej tre (3) muajsh për të vendosur rreth kërkesës për licencim.

Miratimi paraprak

48. Cilat kushte duhet të plotësojë në mënyrë që aplikacioni im për licencë të miratohet në BQK?

BQK-së paraprakisht miraton një licencë vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- nëse plani i biznesit bazohet në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
- struktura organizative e siguruesit të propozuar dhe degëve të tij do t'i lejojë BQK-së të ushtrojë mbikëqyrje efektive dhe të konsoliduar;
- primet e llogaritura dhe provizionet teknike ose matematike janë të mjaftueshme për mbulimin e përgjegjësive të siguruesit;
- siguruesi i propozuar do të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha dispozitat e këtij ligji;
- kualifikimet, përvoja dhe integriteti i drejtorëve apo menaxherëve të saj të lartë janë të përshtatshëm për planin e biznesit të siguruesit të propozuar dhe veprimtarive të sigurimit;
- aksionarët kryesorë, drejtorët dhe menaxherët e lartë të siguruesit të propozuar janë të përshtatshëm dhe të duhur, siç përcaktohet me nenin 24 të këtij Ligjit për Sigurimet dhe përcaktimeve tjera nga BQK-ja, dhe;
- struktura e pronësisë së siguruesit, nuk do të pengoj mbikëqyrjen efektive prej BQK-së.

Përveç siç u cek më lartë, miratimi paraprak i kërkesës për licencë lidhur me një subjekt të varur (filialë) ose degë të siguruesit të jashtëm bëhet vetëm nëse:

- siguruesi i jashtëm është i licencuar për t'u angazhuar në veprimtarinë e sigurimit në juridiksionin ku gjendet drejtoria e saj qendrore;
- autoriteti mbikëqyrës përgjegjës ku ka selinë qendrore siguruesi i jashtëm, ka dhënë pëlqimin e tij me shkrim për dhënien e licencës së këtillë, dhe;
- BQK-ja vlerëson se siguruesi i jashtëm mbikëqyret në mënyrë adekuate në bazë të konsoliduar nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës në shtetin amë. Autoriteti mbikëqyrës përgjegjës nga shteti amë, duhet ta pranojë me shkrim se është në dijeni të dhënies së licencës së re dhe pajtohet që t'i ofrojë informata BQK-së me kërkesë të saj.

Përveç, këtyre që u cekën me lartë, për miratimin paraprak të licencës duhet të përmbushen kriteret sipas Rregullores për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm.

49. A duhet të plotësojë të gjitha kriteret e licencimit?

Po. Si në licencim ashtu edhe në baza të vazhdueshme gjatë zhvillimi të aktivitetit.

50. A ka ndonjë kusht tjetër që merret parasysh nga BQK si kriter për licencim në BQK?

Jo, tjetër kriter licencimi nuk ka, mirëpo BQK-ja do të refuzojë një licencë, nëse nuk përmbushen kriteret e përcaktuara me Ligjin për Sigurime, Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm dhe Manualin për Licencimin e Siguruesve, nëse aplikuesi qëllimisht ka ofruar dokumentacion të falsifikuar dhe nëse gjykon se lëshimi i një licence të këtillë do të:

- vinte në rrezik qëndrueshmërinë financiare të siguruesit të propozuar ose të industrisë së sigurimeve në përgjithësi;
- rrezikonte interesat e policëmbajtesve të siguruesit të propozuar.

51. Çfarë do të thotë miratim paraprak i licencës?

Miratim paraprak do të thotë që aplikacioni juaj sipas zotimeve tuaja ka plotësuar kriteret e BQK-së për licencim. Në rast të miratimit paraprak të një kërkesë për licencë, BQK i përcakton të gjitha kushtet për siguruesin të cilit i jepet licenca për fillimin e operacioneve të saj. Kushte e këtilla mund të përfshijnë:

- pagesën e kapitalit fillestar që aksionarët duhet të bëjnë për siguruesin;
- punësimin dhe trajnimin e personelit të siguruesit;
- blerjen e pajisjeve operative dhe përcaktimin e sistemeve operative;
- marrjen me qira, blerjen ose zotërimin e lokaleve të siguruesit;
- primet e llogaritura dhe provizionet teknike ose matematike janë të mjaftueshme për mbulimin e përgjegjësisë të siguruesit;
- draft-kontratat e sigurimit sipas klasave ku siguruesi kërkon të licencohet;
- angazhimin e një auditori të jashtëm dhe aktuari në përputhje me Ligjin për Sigurimet;
- çdo kusht tjetër që BQK-ja e konsideron të përshtatshëm.

52. Për çfarë periudhe kohore duhet të plotësoj kushtet për miratim të licencës përfundimtare?

Sipas nenit 11 paragrafi 6 të Ligjit për Sigurimet, nëse brenda një (1) viti siguruesi nuk vepron në përputhje me kushtet për marrjen e licencës për fillimin e veprimtarisë, miratimi paraprak i kërkesës do të revokohet.

Licencimi

53. Çfarë ndodhë nëse ndonjëra nga informatat e dorëzuara me aplikacion ndryshon gjatë periudhës së vlerësimit të aplikacionit tim në BQK?

Në rast të ndryshimeve të informatave, mbi bazën e të cilave BQK ka lëshuar miratimin paraprak, aplikuesi për licencë njofton me shkrim BQK-në për faktet ose rrethanat e reja të krijuara. Ky njoftim duhet t'i dërgohet BQK-së menjëherë pasi krijimit të rrethanave të reja, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë

pas paraqitjes së tyre. Nëse ndryshimet që shfaqen gjatë fazës së organizimit ndryshojnë në mënyrë thelbësore faktet në të cilat BQK-ja e ka bazuar miratimin e saj paraprak, ai miratim mund të revokohet.

54. Çfarë duhet të bëjë pas plotësimit të kriterëve për licencë përfundimtare?

Pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara me marrjen e miratimit paraprak për licencë, si dhe kriterëve të përcaktuara me nenin 11 paragrafi 5 të Ligjit për Sigurimet, siguruesi në themelim duhet të aplikojë me shkrim në BQK për marrjen e licencës përfundimtare. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është si në vijim:

- kërkesën me shkrim si dhe një përshtet të shkurtër se kur planifikohet hapja;
- dokumentin bankar që vërteton pagimin e shumës së kapitalit fillestar minimal (kapitali themeltar) sipas kushteve të përcaktuara në nenin 19 të Ligjit për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm;
- Aktet nënligjore/statuti i siguruesit; kontratat, duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit në përputhje me klasën e sigurimit për të cilën ka kërkuar të licencohet;
- dokument valid për fitimin e të drejtës së përdorimit të ambienteve ku do të zhvillohet veprimtaria siguruese. Lokalet duhet të jenë të legalizuara dhe të kenë dokumentacionin e duhur nga autoritetet kompetente.

55. Çfarë do të thotë Ekzaminimi parahapjes?

Ekzaminimi i parahapjes (tash e tutje EPH) është hapi i fundit i procesit të licencimit të siguruesve i cili realizohet nga BQK që të përcaktohet se janë plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe të sigurisë për fillimin e veprimtarisë sipas kërkesave të BQK-së. Ekzaminimi realizohet nga Departamenti për Licencim dhe Standardizim në bashkëpunim me Departamentin për Mbikëqyrje të Sigurimeve në BQK.

56. Sa zgjatë vlerësimi i aplikacionit për licencë përfundimtare?

Brenda katërdhjetë e pesë (45) ditëve nga data e EPH-së, BQK merr vendim me anë të së cilit miraton apo refuzon dhënien e licencës përfundimtare të një siguruesi apo degë të siguruesit të jashtëm. Nëse BQK-ja konstaton se janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 11 paragrafi 5 të Ligjit për Sigurime si dhe me vendimin për miratim paraprak, merr vendim për dhënie të licencës.

57. A mund të refuzohet aplikimi im?

Po, BQK mund të refuzojë aplikimi tuaj nëse nuk plotësohen kriteret për licencim. Me rastin e refuzimit, BQK do të ju informojmë me kohë dhe do të jap arsyetimin e bazuar për refuzim.

58. A mund të apeloj nëse refuzohet kërkesa ime?

Po, ju mund të apelonit vendimin e BQK. Kundër vendimit të BQK-së ju mund të kërkonit nga Gjykata kompetente që ta shqyrtojë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit, por ushtrimi i ankesës nuk e ndalon zbatimin e vendimit.

59. A mund të filloj aktivitetet e organizmit para se të licencohem?

Aplikuesi mund të fillojë organizmin e kompanisë para se të licencohet nga ana e BQK-së. Megjithatë, veprimtaria siguruese nuk mund të fillojë deri sa të jepet një licencë përfundimtare.

60. Nëse firma ime tashmë është e autorizuar, a mund të vazhdojmë me atë që ne tashmë e bëjmë?

Po. Ju mund të vazhdoni të kryeni biznesin për të cilin jeni tashmë të autorizuar gjatë kohës që po kaloni procesin e aplikimit për t'u bërë një sigurues. Sidoqoftë, nuk mund të ndërmerrni aktivitetet për të cilat po aplikoni, derisa të jeni të autorizuar ta bëni këtë.

Siguruesit e jashtëm (huaj)

61. Cili është dallimi në mes të një filiali dhe një dege?

Filial nënkupton një subjekt të varur të siguruesit së huaj, që është nën kontroll të përbashkët me këtë sigurues, ndërsa degë e siguruesit të jashtëm (huaj) nënkupton një subjekt ligjërisht të varur të siguruesit e pa themeluar me vete, nëpërmjet të cilës siguruesi i jashtëm (huaj) angazhohet në veprimtari të sigurimit në Republikën e Kosovë. Për më shumë ju lutem referojuni shtojcës IV të Manualit të Licencimit të Siguruesve.